



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti**  
**mbi trajtimin e ankesave dhe**  
**sugjerimeve të sipërmarrjes**  
**për muajin shkurt 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA**  
**MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit shkurt 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Përgjatë këtij muaji kemi vijuar punën lidhur me përmirësimin e shërbimeve online në drejtim të thjeshtimit dhe digjitalizimit të tyre. Kemi mbajtur takime me ekspertë të ndryshëm, sic ishte dhe takimi me përfaqësues të shërbimeve digjitale qeveritare britanike për të shkëmbyer ide mbi proceset transformuese të shërbimeve. Gjithashtu, në punën tonë kemi përfshirë edhe dhomat e tregtisë dhe shoqatat në vend, por edhe Këshillin Strategjik pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me qëllim përmirësimin e punës dhe qasjes sonë drejt përmirësimit të shërbimeve online.

Aktiviteti Hackathon, i mbështetur nga ekspertët e “EU for Innovation”, ishte një iniciativë shumë e mirë për të rinjtë e talentuar të cilët shprehën dëshirën dhe vullnetin e tyre për të kontribuar me ide inovative drejt nevojave të kryeqytetit, por edhe një mundësi për të identifikuar problematikat që hasin shoqëritë start-up në vendin tonë. Në vijimësi kemi zhvilluar edhe takime periodike me grupin e punës lidhur me projektligjin për shoqëritë start-up për të krijuar një kuadër ligjor dhe politika në nxitje të këtyre shoqërive.

Në kuadër të javës së integritetit, morëm pjesë në mbledhjen e koalicionit të biznesit për anti-korrupsionin organizuar nga ICC, ku morëm pjesë përfaqësues të sektorit privat

dhe institucioneve të ndryshme, për të diskutuar mbi problematikat që hasen nga investorët apo sipërmarrësit.

Me shume interes ishte organizimi i tavolinës së energjisë , ku u zhvillua një debat konstruktiv mbi risitë dhe sfidat në sektorin e energjisë.

Forumi ndërkombëtar i investorëve “ëngjëj”, i mbajtur në Stamboll, ishte një mundësi e shkëlqyer për vendin tonë ku prezantuam risitë e ekosistemit në Shqipëri, hapat e ndërmarra por dhe një mundësi për shkëmbim eksperiencash midis vendeve.

Panairi i IV-të i industrisë së turizmit, Tekno Hotel Expo, mbledhi bashkë sipërmarrës të ndryshëm të këtij sektori për të diskutuar mbi ofrimin e shërbimit, certifikimin e hoteleve dhe mundësinë e rritjes së kapaciteteve.

Nënshkrimi i marrëveshjes për thellimin dhe menaxhimin e BIFIDEX, portalit rajonal të Regjistrimit të Biznesit në Ballkanin Perëndimor, e bëri vendin tonë pjesë të këtij regjistri, udhë e cila do të sjellë jo vetëm rritjen e shkëmbimit të të dhënave por edhe një bashkëpunim ekonomik më efikas me vendet e rajonit.

Akseleratori i konkurrencës dhe inovacionit në Ballkanin Perëndimor, ishte një iniciativë që u ndërmorr gjatë këtij muaji dhe që do të shërbejë si një platformë bashkëpunimi publik-privat dhe që synon të mbështesë rajonin me qëllim konkurrueshmërinë dhe për të siguruar rritje në terma afatgjate.


Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,  
Eduard Shalsi


## Analiza e Ankesave Shkurt 2020

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të formatit të raportimit dhe të krijimit të rrjetit të koordinatorëve, dëshirojmë t'ju paraqesim disa grafikë në lidhje me ankesat për muajin shkurt që vijojnë si më poshtë.


### 1. Shpërndarja e ankesave në baza javore



### 2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



### 3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



### 4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

